



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/176

Datë: 10.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Rriten pagat për të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës në nivelin 25% në pagën bazë nga data 1 prill 2014.
2. Rriten pensionet dhe kompensimet për këto kategori:
  - 2.1. Personat me aftësi të kufizuara, në nivelin 25%
  - 2.2. Invalidët e Luftës, në nivelin 25%
  - 2.3. Pensionistët e hershëm të Trepçës, në nivelin 50%
  - 2.4. Pensionistët e parakohshëm të TMK-së, në nivelin 25%
  - 2.5. Pensionet bazë të kontributdhënësve, në nivelin 25%
  - 2.6. Pensionet bazike, në nivelin 25%
  - 2.7. Pensionistët e pjesëtarëve të FSK-së, në nivelin 25%
  - 2.8. Kompensimet për të verbrit, në nivelin 25%
3. Mjetet nga pika 1. dhe 2. e këtij vendimi ndahen nga programi Kontigjenca për paga (kodi 201-281) dhe transferohen te organizatat buxhetore në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje sipas specifikimit të ndarjeve në nën-programe, të përgatitur nga Ministria e Administratës Publike.
4. Obligohet Ministria e Administratës Publike, Ministria e Financave, dhe të gjitha Organizatat buxhetore për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë